

PROF.ASOC.DR.
LEDINA ALOLLI

KANDIDAT PËR DREJTUES I
NJËSISË KRYESORE
FAKULTETI I EKONOMISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"



PLATFORMA PËR ZHVILLIMIN E FAKULTETIT
TË EKONOMISË
2020-2024

"Së bashku përballë sfidave të së ardhmes"

Të nderuar kolegë!

Të dashur studentë të Fakultetit të Ekonomisë!

Dua të ndaj me Ju kënaqësinë e shpalljes së kandidaturës time për Dekan të Fakultetit të Ekonomisë. Nder dhe përgjegjësi e madhe, të kërkoj besimin tuaj për të drejtuar Fakultetin më të rëndësishëm të Universitetit ”Fan Noli”. Dyfish përgjegjësi, ndaj të gjithëve ju, që pranoni, mirëprisni dhe mbështesni, vizionin tim, për të punuar fort për Universitetin tonë, këtë pasuri për Rajonin dhe jo vetëm, i rrethuar nga vlerat më të mira intelektuale.

Thellësisht mirënjohëse, falenderuese dhe krenare, për punën e profesorëve, kolegëve të mi, për kontributin dhe gjithçka kemi arritur në këto vite përpjekjesh dhe sfidash të mëdha, për edukimin dhe arsimimin e brezave të të rinjve profesionistë dhe kontribues në zhvillimin e vendit.

Kontributi juaj i paëmuar në vite për Fakultetin e Ekonomisë, më bën më të përkushtuar, që së bashku me ju të punoj për të çuar dhe konsolidur më tej sukseset tona dhe për të përballuar sfidat e të ardhmes.

Sfidat janë gjithmonë momente frymëzimi dhe reflektimi, por ato kthehen veçanërisht inkurajuese kur ndodhin në auditoret e Universitetit, në këtë tempull të madh të dijes.

Sfiduese padiskutim mbetet për mua, të marr përsipër të drejtoj elita dhe bashkë me ju, të prodhojmë elita të mirëfillta, munguar ndjeshëm për arsye të ndryshme.

Ju më keni vlerësuar në këto vite dhe më keni besuar përfaqësimin tuaj si Anëtar i Senatit Akademik dhe drejtimin e departamentit Marketing-Turizëm.

Eksperiencia dhe përvoja që kam fituar gjatë viteve të punës sime në Fakultet, më mbushin me besim, më japin kurajo dhe forcë, që të vazhdoj të ofroj më të mirën, për shtëpinë tonë të përbashkët.

Ndihem e motivuar nga bashkëbisedimet me ju dhe ju jam mirënjohëse për mbështetjen, mendimet dhe sugjerimet që janë bërthama e kësaj platforme.

Fakulteti i Ekonomisë është një qendër edukimi për studentët dhe për përparimin e dijes. Së bashku do të vazhdojmë punën, për të përmbushur misionin e Fakultetit të Ekonomisë, duke u mbështetur dhe vlerësuar përvojat pozitive si dhe arritjet e deritanishme.

Platforma ime synon të ofrojë edukim cilësor për studentët, adresim dhe zgjidhjen e problematikave të tyre, avancimin në kërkimin shkencor, duke rritur rolin tonë, në inovacion dhe në zhvillimin ekonomik rajonal.

Për studentët, Universiteti është një shtëpi apo familje e dytë e edukimit dhe rritjes së tyre intelektuale edhe si qytetarë të angazhuar. Ne kemi përgjegjësi të jashtëzakonshme, për të ofruar më të mirën për ta, edhe në situata si kjo që po kalojmë dhe përballemi të gjithë sot. Përvoja jonë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, do të na ndihmojë për ta bërë institucionin të vlerësueshëm dhe konkurrueshëm.

Ne jemi të ndërgjegjshëm për vështirësitë në punën tone. Situata e Pandemisë e vështirësoi edhe më shumë atë. Por puna dhe përkushtimi juaj në mësimdhënie jua bënë më të lehtë procesin e mësimin online studentëve.

Jam e bindur që të gjithë së bashku do të bëjmë më të mirën për Fakultetin tonë. Ndjej emocion, respekt dhe detyrim para profesorëve të mi dhe gjithë stafit akademik dhe ndihmësakademik të Fakultetit të Ekonomisë, studentëve që kanë zgjedhur të studiojnë në Fakultetin tonë, për të paraqitur idetë e mia për zhvillimin e mëtejshëm të Fakultetit, nëpërmjet programit të zhvillimit 2020-2024.


Suksese, për të gjithë kolegët që u përfshinë në këtë proces të ballafaqimit të platformave dhe vizioneve, proces, që dita ditës bëhet më i bukur dhe më inkurajues!

TRE SHTYLLAT KRYESORE MBI TË CILAT DO TË MBËSHTETET
PUNA JONË JANË:

→ EDUKIMI

→ KËRKIMI SHKENCOR

→ FAKULTETI SI NJËSI SIPËRMARRËSE



EDUKIMI

Edukimi do të mbështetet tek një edukim cilësor, teorik dhe praktik të studentëve, të konsoliduar në fushën e tyre të specializimit, me një shkallë të lartë përgjegjshmërie, fleksibiliteti dhe prirje për inovacion.

Objektivat tona do të fokusohen tek:

→ Modernizimi i kurrikulave të programeve ekzistuese të studimit duke u bazuar në të mësuarin me kompetenca, dhe të orientuara nga modelet më të mira të programeve të fakulteteve homologe kombëtare dhe ndërkombëtare, por të ndikuara nga trendet në zhvillimin e vendeve të punës.

→ Programe studimi të mirëstrukturuara, politika dhe procedura që janë eficiente dhe të qëndrueshme, duke pasqyruar një mësimdhënie dhe mësimnxënie bazuar në vlerësim inovativ dhe fleksibël.

→ Përpietje të përbashkëta për zgjerimin e përdorimit të metodave dhe të teknologjive në mësimdhënie, përmes kërkesave intensive dhe transparente për pajisje më bashkëkohore në mësimdhënie në funksion të rritjes së cilësisë.

→ Hapjen e programeve të reja të studimit.

→ Mësimi online që mesa duket do jetë bashkëshoqëruesi i yne, do të jetë një prioritet i rëndësishëm i yni, duke qenë mbështetës, bashkëpunues me studentët duke u krijuar mundësinë për marrjen e njohurive të përformimin e duhur profesional.

→ Rritjen e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat për t'i lidhur programet me kërkesën, aftësitë aktuale dhe kërkesat e njohurive dhe nevojat e ardhshme.

KËRKIMI SHKENCOR

Është burimi kryesor i dijes që mund të përdoret në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Fakulteti i Ekonomisë do të jetë një qendër kërkimore shkencore, që do të ofrojë kontributin e vet për zhvillimin ekonomik të rajonit nëpërmjet produktit shkencor që do të ofrojë.

Strategjitë që lidhen me kërkimin shkencor do të synojnë:

- Fuqizimin e lidhjeve me struktura kërkimi homologe, brenda dhe jashtë vendit.
- Krijimin e kushteve për aktivitete shkencore në bashkëpunim me institucionet kombëtare e ndërkombëtare.
- Bashkëpunimin dhe ndërveprimin me aktorë të interesuar në sektorin publik dhe privat në fushat që ne mbulojmë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.
- Bashkëpunimin me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore.
- Zhvillimin e moduleve në gjuhë të huaj për tërheqjen e studentëve nga mobilitetet Erasmus+.
- Rritjen e rezultateve kërkimore shkencore të stafit akademik në konferenca dhe aktivitete të tjera, brenda dhe jashtë vendit.
- Lidhjen e marrëveshjeve me institucionet publike dhe private për shfrytëzimin e infrastrukturës kërkimore të institucioneve në ofrimin e shërbimeve.
- Rritjen e mundësive për realizimin e punëve kërkimore shkencore dhe projekteve.
- Realizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të Fakultetit, përmes projekteve shkencore, punëve hulumtuese në terren, organizimit të konferencave, tryezave të rrumbullakta, workshop-eve, etj. si dhe nëpërmjet veprimtarisë botuese.
- Sigurimin e zhvillimit profesional dhe mbështetjes nga stafi drejtues i Fakultetit të Ekonomisë.

FAKULTETI I EKONOMISË SI NJËSI SIPËRMARRËSE

Universitetet sot nuk janë vetëm prodhuesite dijes, por dhe "prodhuesit" e aftësive dhe të fuqisë punëtore të arsimuar. Tashmë është e ditur se ekziston një hendek midis aftësive të të diplomuarve dhe aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe për këtë duhet krijuar një marrëdhënie e fortë Universitet – Treg pune. Kërkesat e tregut sot po zëvendësojnë "marrëdhënien e të mësuarit pedagog - student me një marrëdhënie konsumator – ofrues shërbimi".

Nisur nga kjo marrëdhënie, nga njëra anë studentët duhet të ndjekin zhvillimet në tregun e punës për të rritur punësimin e tyre dhe nga ana tjetër Universiteti duhet të ofrojë programe në mënyrë që të lehtësojë nevojat e studentëve. Kjo na çon tek "Edukimi i lartë i orientuar nga kërkesa", që do të nxisë një mentalitet sipërmarrës për studentët dhe akademikët duke nxitur inovacionin dhe duke shmangur efektet negative të ofertës së lartë të të diplomuarve në tregun e punës.

Studentët janë produkti ynë dhe ne suksesin e arrijmë duke plotësuar nevojat dhe pritshmëritë tyre. Oferta jonë duhet t'i përshtatet kërkesave të tregut. Formimi i të diplomuarve është i rëndësishëm për punësimin e tyre, sepse të fitosh një vend pune është padyshim një nga objektivat më të mëdha të studentëve të sapo diplomuar.

FAKULTETI I EKONOMISË SI NJËSI SIPËRMARRËSE

SI DO TË OPEROJË FAKULTETI I EKONOMISË SI NJËSI SIPËRMARRËSE?

- Rritja e rolit të Fakultetit të Ekonomisë në ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve.
- Edukimi i orientuar nga kërkesa e tregut të punës.

RRITJA E ROLIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE NDAJ TË TRETËVE.

Bashkëpunimi i një trinomi: Fakultet-Biznes Qeverisje në nivel qendror dhe lokal. Ky bashkëpunim i ngushtë do të krijojë mundësinë që Fakulteti nëpërmjet ideve, aftësive, njohurive dhe potencialeve që disponon në fushën akademike dhe kërkimore, të ofrojë kontribut në rritjen e zhvillimit ekonomik, rajonal, qytetar dhe individual.

EDUKIMI I ORIENTUAR NGA KËRKESA E TREGUT TË PUNËS.

- Përmirësimi i programeve duke bërë të mundur që të diplomuarit të jenë të gatshëm të hyjnë në tregun e punës.
- Realizimi i intershipe-ve në kompani apo organizata do ju krijojë mundësi studentëve të aplikojnë dijet e tyre teorike.
- Informacion i përditësuar për studentët mbi mundësitë e tregut të punës, që i ndihmon ata të marrin vendime të rëndësishme në lidhje me karrierën e tyre.
- Garantimi i konkurrueshmërisë së studentëve në tregun rajonal e më gjerë, për të plotësuar interesat akademike që kanë studentët për të lëvizur nga njëri vend tek tjetri.

FAKULTETI I EKONOMISË SI NJËSI SIPËRMARRËSE

KRIJIMI I QENDRËS SË FORMIMIT TË VAZHDUAR

SI DO TË OPEROJË FAKULTETI I EKONOMISË SI NJËSI SIPËRMARRËSE?

- Krijimi i Qendrës së Formimit të Vazhduar.
- Qendra e formimit të vazhduar do të ndihmojë në krijimin e ofertës akademike duke nxitur kapacitetet dhe talentet e studentëve, që të dalin nga auditori si punëkrijues e punëdhënës, dhe jo vetëm si punëmarrës në tregun e punës.
- Stafi i kualifikuar akademik do të ofrojë trajnime, për target grupet (studentët, studentët ALUMNI dhe specialistët e ndryshëm), programe kursesh për rritjen e aftësive të të rinjve në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me programet tona të studimit, duke u përshtatur kërkesave të kohës (në fushën e financës, marketingut digital, turizmit apo menaxhimit).
- Pedagogët do të ofrojnë programe, platforma dhe iniciativa të bazuara në dije që nxisin të mësuarit duke punuar e krijuar, duke i pajisur me dije të aplikuara e aftësi e cilësi konkurruese për tregun e punës.
- Qendra e formimit të vazhduar do të ndihmojë në përgatitjen e studentëve për të "Ardhmen Digjitale".
- Kjo qendër do të jetë një burim të ardhurash për Fakultetin.

FAKULTETI I EKONOMISË

PRIORITETET STRATEGJIKE

2020-
2024

MËSIMDHËNIA DHE
MËSIMNXËNIA

PUNA KËRKIMORE-SHKENCORE

NIVELI I STUDIMEVE DHE
PROGRAMET E REJA

ZHVILLIMI I BURIMEVE
NJERËZORE

ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS

TRANSARENCA, LLOGARIDHËNIA
DHE PËRMIRËSIMI I DHËNIES SË
INFORMACIONIT

PRIORITETET STRATEGJIKE

MËSIMDHËNIA DHE MËSIMNXËNIA

- Përmirësimi i mësimdhënies përmes metodologjive të reja.
- Sigurimi i zhvillimit të mëtejshëm të stafit akademik.
- Ngritje e performancës akademike.
- Përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies.
- Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi i programeve të studimit.
- Përmirësimi i mësimdhënies për të arritur rezultatet më të mira duke u bazuar në standardet ndërkombëtare.
- Rritja e cilësisë së stafit akademik, progresit të studentëve, vlerësimi i lëndëve dhe rezultatet e përgjithshme rreth këtij procesi.
- Rritja dhe përmirësimi i rezultateve shkencore dhe kërkimore në Fakultetin e Ekonomisë.
- Përforsimi i marrëdhënieve për mundësi zhvillimi e bashkëpunimi me institucione të tjera.

PUNA KËRKIMORE SHKENCORE

- Rritja e rezultateve kërkimore shkencore të stafit akademik në aktivitete brenda dhe jashtë vendit.
- Sigurimi i zhvillimi profesional dhe mbështetjes nga stafi drejtues i Fakultetit të Ekonomisë.
- Rritja e mundësive për realizimin e punëve kërkimore shkencore dhe projekteve.
- Krijimi i kushteve për aktivitete shkencore në bashkëpunim me institucionet kombëtare e ndërkombëtare.

NIVELI I STUDIMEVE DHE PROGRAMET E REJA

- Zbatimi i programeve të studimeve në pajtim me nevojat e tregut.
- Zhvillimi i rezultateve të matshme të programeve e studimit.
- Nxitja për studime tregu me qëllim krijimin e programeve të reja të studimit.

ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

- Nxitje për rritje profesionale dhe akademike të stafit akademik.
- Nxitje për rritje të trajnimeve për stafin ndihmës-akademik.
- Krijimi i mundësive për pjesëmarrje në projekte dhe punën kërkimore shkencore.

ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS

- Nxitje për përsheptimin e rikonstruksionit të godinës së Fakultetit Ekonomik për krijimin e një infrastrukture me mjedise të përshtatshme pune jo vetëm për pedagogët por edhe për studentët.
- Krijimi i kushteve më të mira, moderne dhe përmirësimi të teknologjisë në mjediset e Fakultetit.
- Ndërtimi i një plani për ndryshime të infrastrukturës bazuar në kërkesat dhe sugjerimet e stafit akademik, ndihmës-akademik dhe studentëve.

TRANSAPERENÇA, LLOGARIDHËNIA DHE PËRMIRËSIMI I DHËNIES SË INFORMACIONIT

- Transparencë në proceset vendimarrëse të fakultetit.
- Konsultimi i vazhdueshëm dhe sigurimi i llogaridhënies në raport me punën, programet dhe rezultatet e punës në fakultet.
- Përmirësimi i dhënies së informacionit nga struktura ndihmës-akademike dhe garantimi për marrjen e shpejtë të këtij shërbimi.



STAFI I FAKULTETIT TË EKONOMISË

Suksesi i objektivave tona do të mbështetet tek tradita, eksperiencia, përvoja dhe aftësitë e padiskutueshme të stafit akademik për të cilin sot e ndjej veten krenare që jam pjesë e tij.

Personalisht në cilësinë e anëtares së Senatit Akademik dhe stafit të Fakultetit të Ekonomisë kam mbështetur maksimalisht zhvillimin e karrierës së kolegëve, e cila ka rëndësi si për ta ashtu edhe për institucionin.

Stafi i Fakultetit të Ekonomisë është i angazhuar cilësisht në mësimdhënie, në punën kërkimore shkencore në funksion të procesit mësimor.

Parimet e përgjithshme të drejtimit të fakultetit do të bazohen në kulturën e bashkëpunimit dhe reciprocitetit, angazhimin, përgjegjshmërinë sociale, cilësinë, fokusi rajonal, fokusin tek studentët, parimin e transparencës, parimin e lidhjeve afatgjata.

STAFI I FAKULTETIT TË EKONOMISË

Suksesi i objektivave tona do të mbështetet tek tradita, eksperiencia, përvoja dhe aftësitë e padiskutueshme të stafit akademik, për të cilin e ndjej veten krenare që jam pjesë e tij.

Personalisht në cilësinë e Përgjegjësës së Departamentit Marketing-Turizëm, si dhe të anëtares së Senatit Akademik të UK, kam mbështetur maksimalisht zhvillimin e karrierës së kolegëve, e cila ka rëndësi si për ta ashtu edhe për institucionin.

Stafi i Fakultetit të Ekonomisë është i angazhuar cilësisht në mësimdhënie si dhe në punën kërkimore shkencore në funksion të procesit mësimor.

Parimet e përgjithshme të drejtimit të Fakultetit do të bazohen në kulturën e bashkëpunimit dhe reciprocitetit, angazhimin, përgjegjshmërinë sociale, cilësinë, fokusi rajonal, fokusin tek studentët, parimin e transparencës, parimin e lidhjeve afatgjata.

Prioritet i punës sime do të jetë mbështetja e kolegëve të mi duke krijuar kushte optimale për zhvillimin e karrierës, mundësi për pasurimin e CV profesionale dhe promovimin akademik, si çelësi që përcakton nivelin e edukimit dhe arritjet në fushën e kërkimit shkencor.

Një nga shqetësimet e kolegëve në punën e tyre për ecuri në karrierë, ka qenë mbështetja financiare. Unë do të ofroj mbështetjen time maksimale, për të bashkëpunuar me strukturat përkatëse, që të aplikojnë politika mbështetëse financiare për pedagogët.

Stafi akademik do të mbështetet për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, për pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare dhe publikimet shkencore, për pjesëmarrjen në projekte dhe mobilitete akademike, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira europiane.

Inkurajim për përdorimin e metodave moderne krahas atyre tradicionale të mësimdhënies dhe krijimin e të gjitha kushteve për përdorimin e këtyre metodave.

Procesi i akreditimit aktual ka qënë shumë i rëndësishëm. Mbështetja do të vijojë edhe për programet e tjera me qëllim përmbylljen e të gjithë programeve të Fakultetit të Ekonomisë.

Vlerësimi dhe shpërblimi brenda kuadrit ligjor i çdo pune të stafit akademik që angazhohet në aktivitete të ndryshme për përmbylljen e misionit dhe objektivave të Fakultetit të Ekonomisë.

Krijimi i kushteve që Fakultetit i Ekonomisë përmes procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të ndikojë në të gjithë rajonin, si edhe të përqëndrojë përpjekjet për bashkëpunime edhe përtej rajonit.

Transparencë ndaj të gjitha proceseve dhe veprimtarive që zhvillohen në Fakultetin e Ekonomisë. Ky parim do të garantohet përmes vënies në dispozicion të të gjithë informacionit të vlefshëm për stafin dhe studentët.

Fakulteti i Ekonomisë do t'i kushtojë rëndësi krijimit dhe ruajtjes së lidhjeve afatgjata me ish-studentët (ALUMNI) dhe ish-anëtarë të stafit akademik. Përfshirja e kapaciteteve intelektuale në procesin mësimor do të jetë një kontribut në rritjen e vlerave të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.



STUDENTËT E FAKULTETIT TË EKONOMISË

Përmes fokusit tek studentët synohet të merren në konsideratë në mënyrë sistematike nevojat, pritshmëritë dhe eksperiencat e studentëve.

Fakulteti i Ekonomisë ka përgjegjësinë e formimit të specialistëve në fushën e ekonomisë, biznesit e turizmit dhe është detyrim i joni që ata të marrin më të mirën në çdo dimension të jetës së tyre studentore.

Këshilli studentor dhe të gjithë studentët do të mbështeten dhe asistohen në çdo moment nga stafi akademik dhe autoritetet drejtuese të Fakultetit të Ekonomisë..

STUDENTËT E FAKULTETIT TË EKONOMISË

Futja e **konceptit të "mentorimit"** - çdo pedagog do të ketë një klasë në udhëheqje. Përmes krijimit të një mjedisi bashkëpunues do të garantohet që pedagogu të jetë udhëheqës dhe drejtues i punës së përditshme të studentëve.

Ngritjen e një komisioni ad hoc për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çdo problematike.

Fakulteti dhe departamentet do të jenë mjedise ku studenti do gjejë mbështetjen e plotë dhe pa pengesa për të ushtruar të gjithë veprimtarinë studimore, kërkimore, edukative, kulturore, sportive, etj.

Programet studimore do të përmirësohen me laboratorë funksionale, ku studenti të ushtrojë anën praktike të mësimdhënies.

Mbështetje maksimale ndaj këshillit studentor të Fakultetit të Ekonomisë, me qëllim që ato të jenë një pjesë aktive dhe zë i fuqishëm në zgjidhjen e problematikave dhe sjelljen e risive brenda fakultetit.

Mbështetje e studentëve në organizimin dhe pjesëmarrjen në ngjarje shkencore e profesionale.

Përfshirje e studentëve në implementimin e projekteve të ndryshme kërkimore nën mbikqyrjen e stafit akademik.

Inkurajim dhe mbështetje maksimale ndaj mobiliteteve studentore akademike duke synuar një rritje të numrit të mobiliteteve të studentëve në kuadër të programit Erasmus+.



**F
O
K
U
S
I

T
E
K

S
T
U
D
E
N
T
Ë
T**

STUDENTËT E FAKULTETIT TË EKONOMISË

Pasurimi i bibliotekës së Fakultetit me literaturë bashkëkohore në fushën e ekonomisë.

Mbështetje maksimale në nivel Fakulteti me staf dhe hapësira fizike moderne të dedikuara me qëllim lehtësimin e kalimit të studentëve tanë drejt tregut të punës.

Mbështetje maksimale për krijimin e mundësive të punësimit të studentëve përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private.

Të gjitha sugjerimet, kërkesa, vendimet që prekin jetën studentore do të diskutohen në tryeza të hapura me pjesëmarrjen e stafit akademik, administrativ dhe studentor të Fakultetit të Ekonomisë.

Zhvillimi i mjediseve bashkëkohore dhe inovatore ku studentët të kenë mundësi të shpalosin vlerat e tyre.

Rritja e partneriteteve për praktika dhe punësim në institucione publike dhe private për studentët e Fakultetit të Ekonomisë.



NDËRKOMBËTARIZIMI DHE RRJETËZIMI I FAKULTETIT TË EKONOMISË

Në kuadër të ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Ekonomisë, do të synohet rritja e pranisë dhe aktiviteteve të fakultetit, në rrjetin europian dhe global të arsimit të lartë.

Ofrimi i programeve në gjuhën angleze, në programet që janë atraktive për tregun dhe që studentëve me një diplomë të tillë do t'u hapte edhe më tutje rrugët në karrierë, duke krijuar mundësi për diploma të përbashkëta me universitete partnere.

Angazhim i profesorëve vizitorë (ligjërues dhe hulumtues) në Fakultetin e Ekonomisë.

Përkrahja e stafit për projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare.

Rritja e numrit të marrëveshjeve dhe e mobiliteteve në kuadër të programit Erasmus për shkëmbimin e stafit dhe studentëve.

Rritje e numrit të bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore në organizmin e aktiviteteve ndërkombëtare.



PROF.ASOC.DR. LEDINA ALOLLI

Ky program nuk është as i ngurtë dhe as perfekt, prandaj janë të mirëpritura sugjerimet Tuaja për të realizuar përmirësimet e mundshme.

Faleminderit



+355 69 20 23 036



Shëtitörja Rilindaasit,
Fakulteti Ekonomik, Kati i II,
Zyra nr. 202



ledinaalolli@gmail.com

FAKULTETI I EKONOMISË

“SË BASHKU PËRBALLË
SFIDAVE TË SË ARDHMES”

Prof.Asoc.Dr. Ledina Alolli

KANDIDATE PËR DREJTUES I NJËSISË KRYESORE, FAKULTETI I EKONOMISË,
PROF.ASOC.DR. LEDINA ALOLLI

PËR STUDENTËT

MISIONI I FAKULTETIT TË EKONOMISË

Misioni kryesor i ekzistencës së Fakultetit të Ekonomisë ka qenë dhe do të jetë edukimi, formimi i profesionistëve të zotë në sektorin ekonomik duke kontribuar në zhvillimin e rajonit dhe më gjerë.

Puna jonë fillon dhe mbaron me studentët, me mundësinë për të dhënë më të mirën tonë duke sjellë një vlerë të shtuar në shoqëri.

Një shprehje që përdorim në marketing thotë: "I pandryshueshëm është vetëm NDRYSHIMI". Kjo shprehje e vendos theksin tek rëndësinë që ka koha që jetojmë, dhe përshtatja e cila duhet të jetë objektivi i përditshëm në sfidat që kemi para.

Teknologjia ka sjellë një qasje tjetër ndaj jetës sonë duke na vendosur sfida që kërkojnë përgatitje dhe bashkëpunim për t'u kaluar.

ME VËMENDJEN TEK STUDENTËT:

- Mentoring për secilin program dhe për çdo student sipas kërkesës së çdo studenti përgjatë gjithë kohës së studimeve.
- Përmirësim i vazhdueshëm i programeve dhe metodologjisë së mësimdhënies, rritjes së mbështetjes për formimin profesional të studentëve brenda dhe jashtë fakultetit.
- Planifikimi i praktikave profesionale duke vendosur bashkëpunim të qëndrueshëm me faktorët e tregut në nivel institucional.
- Mbështetje dhe nxitje për mundësinë e mobiliteteve të studentëve në kuadër të projekteve Erasmus dhe Erasmus+.
- Hapja e Qendrës së Aktivitetit Praktik të studentëve. Një qendër ku studentët do të kenë mundësi të përdorin infrastrukturën për të praktikuar dijet dhe për të ofruar shërbim ndaj biznesit.
- Mbështetje e studentëve në programet Master Profesional dhe Master Shkencor për zhvillimin e mikrotezave dhe mbrojtjen e diplomës
- Mbështetje për aktivitete sportive, kulturore, artistike, sociale dhe vullnetare.
- Mbështetje për programet profesionale 2-vjeçare.



VIZIONI

Fakulteti i Ekonomisë do të vazhdojë të jetë një model menaxhimi i karakterizuar nga bashkëpunimi i ngushtë "staf drejtues-student" lidhur me transformimin e jetës studentore në mjedisin universitar.



STUDENTI I PARI

STUDENTI PJESE E
VENDIMARRJES DHE
MENAXHIMIT

STUDENTI PJESE E
ZHVILLIMIT DHE
FORCIMIT TË
FAKULTETIT

FAKULTETI I EKONOMISË

PËRVOJË UNIKE E STUDIMEVE

DËGJESAT

Çdo student do të ketë të drejtën të dëgjohet përmes adresimit të kërkesave, sugjerimeve apo ankesave drejtpërdrejt tek dekanati përmes komunikimit direkt ose përmes postës elektronike.

KËRKIMI

Studentët do mbështeten në dy drejtime kërkimore: punimi i diplomës dhe prezantimi i punimeve të tyre kërkimore në revistën "Studime Ekonomike" e Fakultetit të Ekonomisë, në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.



MENTORIMI

Krahas klasave që do të kenë një udhëheqës mentorues, çdo student që do të shprehë kërkesë vetjake do të udhëhiqet nga një pedagog përgjatë gjithë kohës së studimeve në Fakultetin e Ekonomisë.

ECURIA NË KARRIERË

Do të sigurohet një bashkëpunim i plotë dhe efikas, ku çdo ofertë pune, intershipi dhe praktike e Qendrës së Qendrës së Karrierës dhe Alumnit do t'u bëhet së pari e ditur studentëve të Fakultetit të Ekonomisë.

MJEDISI AKADEMIK

Staf bashkëpunues, mbështetës, i hapur, me vizion të ri për punën akademike dhe me ide inovative për avancimin e mëtejshëm të studentëve.

BURIMET DHE INOVACION

Të gjitha veprimtaritë e Fakultetit të Ekonomisë minimalisht do të kenë burime financiare dhe njerëzore të gatshme si edhe do të orientohen drejt praktikave bashkëkohore.

PJESËMARRJA E STUDENTEVE

Fuqizimi i rolit dhe ndikim për pjesëmarrje të studentëve në vendimarrjet e Fakultetit të Ekonomisë.

FAKULTETI I EKONOMISË

MJEDISI I FAKULTETIT TË EKONOMISË

MJEDIS BASHKËPUNUES

MENTORIMI

çdo pegagog do të ketë një klasë në udhëheqje

Garantimin e të gjithë kushteve dhe mundësivë që pegagogu të jetë udhëheqës dhe drejtues i punës së përditshme të studentëve

MJEDIS MBËSHTETËS ADMINISTRATIV

LEHTËSIM

Lehtësim i procedurave për marrjen e dokumentave

kohëzgjatja e tërheqjes së dokumentave do të jetë jo më shumë se 5 min në FE.

MJEDIS NDËRVEPRUES


PLOTËSIM

Ngritjen e një komisioni ad hoc për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çdo problematike

Komisioni ad hoc do të kryesohet nga dekani i Fakultetit të Ekonomisë në bashkëpunim me Kryetarin e KS dhe një trupë prej 3 pedadogësh

FAKULTETI I EKONOMISË

MJEDISI I FAKULTETIT TË EKONOMISË



PROFILI I STUDENTIT

Përmes vizionit të ri synoj të nxit një komunikim më të gjërë, më gjithëpërfshirës dhe rol vendimarrës të studentëve në jetën akademike.


STAFI AKADEMIK

Do të angazhohet në plotësimin e kërkesave të çdo studenti, mbështetjen e studentëve përtej auditorit dhe do të sigurohet komunikimi aktiv për çdo paqartësi që lidhet me ecurinë e mësimdhënies në fakultet.

FAKULTETI DHE DEPARTAMENTE

Do të jenë mjedise ku studenti do gjejë mbështetjen e plotë dhe pa pengesa për të ushtruar të gjithë veprimtarinë studimore, kërkimore, edukative, kulturore, sportive, etj.

INOVACIONI NË FAKULTETIN E EKONOMISË



PROGRAMET STUDIMORE

Do të plotësohen me laboratorë funksionale, ku studenti të ushtrorë anën praktike të mësimdhënies.



AUDITORET

Do të përmbushin të gjithë kushtet fizike që mësimdhënia të kryhet sipas standardeve më të mira në ditët e sotme.



KËRKESAT E STUDENTËVE

Do të krijohet një postë elektronike që do të kontrollohet nga dekanati, ku studentët do të shprehin çdo propozim, shqetësim apo sugjerim për procesin mësimor.



ZGJIDHJA E PROBLEMEVE



Zëri i studentëve

Impakti i studentëve

Shërbimi i orientuar

Sekretaritë
Auditori
Praktika
Mjediset Fizike
Komunikimi i pedagogëve
Logjistika e laboratorëve

**ADRESIM I
PROBLEMEVE**

**ZGJIDHJE E
PROBLEMEVE**



JU DO TË JENI VLERËSUESIT TANË!

Fakulteti i Ekonomisë do të zhvillojë
anketim periodik 3 mujor për
vlerësimin e punës, komunikimit dhe
bashkëpunimit të pedagogëve me
studentët.

PLANE PËR ZHVILLIM

2020-2024

- FUQIZIMI DHE ZHVILLIMI I ONLINE LEARNING.
- KRIJIMI I QENDRËS SË FORMIMIT TË VAZHDUAR.
- RRITJA E PARTNERITETIT PËR PRAKTIKA DHE PUNËSIM NË INSTITUCIONE PUBLIKE DHE PRIVATE PËR STUDENTËT E FE.
- ZHVILLIMI I MJEDISEVE BASHKËKOHORE DHE INOVATORE.
- KRIJIMI I QENDRËS SË AKTIVITETI PRAKTIK.
- RRITJA E PARTNERITETIT ME INSTITUCIONE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE TË ARSIMIT TË LARTË.
- RRITJA E MUNDËSIVE PËR MOBILITET TË STAFIT DHE STUDENTËVE.
- PROGRAM TË DEDIKUAR PËR SHKËMBIMIN E STUDENTËVE NË NIVEL KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR.

SË BASHKU DO T'I KTHEJMË STUDIMET NË NJË PERIUDHË TË PAHARRUESHME!

KONTAKTONI ME MUA



+355 69 20 23 036



ledinaalolli@gmail.com



Fakulteti i Ekonomisë
Kati i dytë, zyra nr. 202

"SË BASHKU PËRBALLË SFIDAVE TË SË ARDHMES"
PROF.ASOC.DR. LEDINA ALOLLI



LEDINA AOLLI

KANDIDATE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE FAKULTETI I EKONOMISË

ARRITJE

- Titulli "Doktor Shkencash" - Universiteti i Tiranës (2009)
- Titulli "Profesor i asociuar" - Vendim nr 13/2012 i Këshillit të Universitetit "Fan S. Noli"

STUDIMET UNIVERSITARE

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Bachelor në Marketing

- Fakulteti i Ekonomisë
- 1993-1997

Universiteti "NeofiltRilski", Bllagoevgrad

Master Shkencor në Administrim Biznesi

- Fakulteti i Ekonomisë
- 2003-2005

QËNDRO NË KONTAKT

Cel: +355 69 20 23 036

Email: ledinaalolli@gmail.com

Facebook: @Ledinaalolli

Instagram: @ledina_alolli

EKSPERIENCA E PUNËSIMIT

PEDAGOGE - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"

Fakulteti i Ekonomisë | 2013 - në vazhdim

Lëndët: Sjellje Konsumatore/ Strategji Marketing/ Ekonomia dhe politikat globale integruese/ Menaxhimi marketing i biznesit

- Anëtare e Senatit Akademik
- Përgjegjëse e Departamentit të Marketing-Turizëm

PEDAGOGE - UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

Fakulteti i Ekonomisë | 2018 - 2019

DEPUTETE- KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

2009 - 2013

- Pedagoge e Jashtme në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti Korçë
- Pedagoge e Jashtme në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
- Anëtare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat.
- Anëtar zevendësues në Komisionin parlamentar të Edukimit dhe Medias.
- Anëtare e Sekretariatit për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet në Kuvendin e Shqipërisë

PEDAGOGE - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"

Fakulteti i Ekonomisë | 2002- 2009

Lëndët: Kërkim marketing/ Strategji Marketing/ Sjellje konsumatore

- Anëtare e Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë

PUBLIKIME

- Brenda vendit:

- 1) nëntë (9) publikime në revista dhe periodikë shkencorë.
- 2) një (1) publikim në konferencë shkencore kombëtare.

- Jashtë vendit:

- 1) katër (4) publikime në revista dhe periodë shkencorë.
- 2) gjashtëmbëdhjetë (16) publikime në konferenca shkencore ndërkombëtare.